



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2021:115143
Datë: 07.11.2024
Numri i dokumentit: 06419528

P.68/2021

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ DEGA KAÇANIK, Gjyqtari Burhan Berisha, me bashkëpunëtorin profesional Ismail Kuçi në çështjen përmbaremore të kreditorit N. Q. nga Kaçaniku, rr. '...' nr.30, kundër debitorit N. Q. 1 nga Kaçaniku rr. '...' nr.28, për pagesën e borgjit, duke vendosur për prapësimin e ushtruar nga debitori, me datë 07.10.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit N. Q. 1 nga Kaçaniku rr. '...' nr.30, i ushtruar kundër urdhrit mbi lejimin e përmbaremit P.nr.288/2021, i datës 19.05.2021, i lëshuar nga përmbareuesi privat B. A. me seli në Ferizaj dhe **MBETET** në fuqi urdhri për lejimin e përmbaremit P.nr.288/2021, i datës 19.05.2021.

DETYROHET, debitori që ta bëjë ekzekutimin e propozimit Urdhërit Përmbaremor P.nr.288/2021, i datës 19.05.2021, i lëshuar nga përmbareuesi privat B. A. me seli në Ferizaj, si dhe të paguaj shpenzimet e procedurës aq sa do t'i vlerësoj organi përmbareues, kjo pagesë do të bëhet në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit në dorëzim të këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Kreditori urdhrin P.nr.288/2021, i datës 19.05.2021, përmbaruesi privat B. A., e ka lejuar përmbarimin e propozuar nga kreditori N. Q. nga Kaçaniku, rr.'...' nr.30, kundër debitorit N. Q. 1 nga Kaçaniku rr.'...' nr.28.

Me këtë propozim ka kërkua nga përmbaruesi që të lejohet përmbarimi dhe të obligohet që në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, **Debitori** që të lejoj caktimin e kufijve të Nk.nr.535/3 vendi i quajtur ..., me sipërfaqe prej 277 m2, ZK Kaçanik, sipas Certifikatës së pronës Nr.... i datës 09.11.2016, në bazë të Aktvendimi i Gjykatës Themelore Ferizaj-Dega në Kaçanik N.nr.50/2007 të datës 28.09.2009 dhe aktvendimi për korrigjim N.nr.50/2007 të datës 02.11.2016, i formës së prerë nga data 15.10.2009, si dhe pagesën e shpenzimeve të procedurës përmbarimore, ose ndalimin e mjeteve në para të cilat i ka debitori në llogaritë bankare dhe nga xhirollogaria e debitorit të barten në xhirollogarinë bankare të përmbaruesit privat ose regjistrimin, sekuestrimin, vlerësimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit.

Përmbaruesi privat më datë 09.06.2021, e ka nxjerrë urdhërin P.nr.288/2021, i datës 19.05.2021, me të cilin e ka lejuar ekzekutimin, po ashtu me këtë urdhër e ka udhëzuar debitorin që në afat prej 7 ditëve mundë të paraqes prapësim kundër urdhrit për përmbarim.

Përmbaruesi privat një kopje të propozimit për përmbarim së bashku me urdhërin për lejimin e ekzekutimit, me datën 25.05.2021 i'a ka dorëzuar debitorit, i cili më datë 31.05.2021, ndaj urdhërit përmbarues ka paraqitur prapësim me të cilin i ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit dhe të anulohet Urdhri P.nr.288/2021 i datës 19.05.2021.

Debitorit me prapësim i ka propozuar gjykatës, që prapësimi të aprovohet si i bazuar dhe të anulohet urdhëri i përmbaruesit privat P.nr.288/2021, i datës 19.05.2021,

Gjykata e refuzoi prapësimin e debitorit si të pa bazuar, për arsye se debitori prapësimin nuk e ka mbështetur në prova, asnjë provë nuk ja ka bashkangjitur prapësimi siç është paraparë me nenin 69 par.4 të LPP-së si dhe nuk ka paraqitur asnjë nga shkaqet e parapara me nenin 71 nga pika 1.1 deri tek pika 1.12 të LPP-së.

Gjykata i analizoi pretendimet Kreditori të paraqitura në propozimin për përmbarrim dhe në përgjigje në prapësim dhe të njëjtave ua fali besimin për shkak se ishin të drejta dhe të ligjshme për të gjitha arsyet e cekura më lartë.

Gjykata i analizoj të gjitha provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës si dhe pretendimet e kreditorit, këtyre pretendimeve gjykata u fali besimin dhe vendosi si më lartë. Këto theksime gjykata i miratoj sepse propozimi për përmbarrim është i bazuar në neni 22 të Ligjit të procedurës përmbarrimore në vendimi përmbarrues të në bazë të Aktvendimit të Gjykatës Themelore Ferizaj-Dega në Kaçanik N.nr.50/2007 të datës 28.09.2009 dhe aktvendimi për korrigjim N.nr.50/2007 të datës 02.11.2016, i plotfuqishëm nga data 15.10.2009 dhe i ekzekutueshëm.

Gjykata i analizoi edhe pretendimet e debitorit, të paraqitura në prapsim, mirëpo këto pretendime nuk kishin ndikim që të vendosej ndryshe, sepse prapësimi i debitorit është i pa bazuar në prova dhe duke u bazuar në dispozitën ligjore të nenit 69 par .4 të LPP-së nenit 71 nga pika 1.4, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Debitori e kundërshton të drejtën e kërkesës me qka konsider dhe konsideron se ka skaduar afati kohorë brenda të cilit sipas ligjit mundë të kërkohej përmbarrimi, po ashtu në bazë të nenit 361 par.1 të LMD-së është përcaktuar se të gjitha kërkesat që janë përcaktuar me vendim të formës së prerë ose me anë të pajtimit para gjykatës ose organit tjetër kompetent, parashkruhen për dhjetëvjetë dhe të cilat ligji edhe ashtu parashikon afatë më të shkurtër parashkrimi, për periudhën më të gjatë se një vjeçare dhe me këtë rast kërkesa e kreditorit është parashkruar.

Gjykata po ashtu i ka analizuar edhe pretendimet e debitorit, i cili ka theksuar se kërkesa e kreditorit është parashkruar, për arsye se kanë kaluar më shumë se 5 vite, por këto theksime gjykata nuk mori për bazë me rastin e vendosjes, sepse në rastin konkret kemi të bëjmë me vendim gjyqësor, vendimet gjyqësore parashkruhen në afat prej 10 viteve, kjo qështje është e rregulluar me dispozitat e LDM-së neni 361 par.1 Ku thuhet se: *“Të gjitha kërkesat që janë vërtetuar me vendim të formës së prerë të gjykatës ose me vendim të organit tjetër kompetent, ose me ujdinë e palëve para gjykatës apo organit tjetër kompetent, parashkruhen për dhjetë (10) vjet, madje edhe ato për të cilat ligji edhe ashtu parashikon afat më të shkurtër për parashkrim”* andaj gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Duke marrë për bazë gjendjen faktike gjykata rrjedhimisht konstaton se debitori nuk ka paraqitur asnjë nga shkaqet e parapara me nenin 71 nga pika 1.1, andaj gjykata duke i pasur për bazë të gjitha këto fakte të konstatuara vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata i ka analizuar edhe pretendimet e debitorit i cili ka kërkuar nga gjykata që prapësimin i debitorit të miratohet dhe të anulohet urdhri dhe propozimi për përmbarim të refuzohet. Këto pretendime gjykata si mori për bazë me rastin e vendosjes debitori prapësimin nuk e ka mbështetur me prova të duhura dhe ato prova nuk i'a ka bashkangjitur prapësimin ashtu siq është paraparë me nenin 69 par.4 të LPP-së.

Nga sa u thekësua më lart dhe duke u mbështetur në nenin 77 par 1 të LPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi,

Gjykata e detyroi debitorin që kreditorit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës përmbarimore të cilat do të llogariten nga përmbaruesi privat , bazuar në nenin 13 të LPP-

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

DEGA KAÇANIK

PPP.nr.68/2021, më datë 07.10.2024

GJYQTARI

Burhan Berisha

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në afatin prej 7 ditësh, nga dita e pranimin të këtij aktvendimi.